



## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

---

### V E N D I M

Nr. 23, datë 07.02.2019

#### MBI

### MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË  
PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT (I NDRYSHUAR)**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 07.02.2019, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë” si dhe nenit 46 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

#### V E N D O S I:

1. Miratimin e “Rregullore për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimin.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. Çdo rregullim tjetër, që bie ndesh me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore shfuqizohet.
4. Kthimin pa veprim të çdo pëlqimi të dhënë për transferim të përkohshëm nga gjyqtarët, të bëra para miratimit të kësaj Rregullores.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### RREGULLORE

### MBI KRITERET DHE PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 46 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**Vendosi:**

**Neni 1**

**Objekti**

1. Objekt i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit sipas nenit 46 ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **Neni 2**

### **Subjektet**

1. Subjekte të kësaj Rregulloreje janë gjyqtarët që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë të cilëve nuk u është kufizuar ushtrimi i funksionit për shkaqe të parashikuara në ligj.

## **Neni 3**

### **Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr.96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a. “Gjykatë në nevojë” nënkupton gjykatën në të cilën ka një ose disa pozicione të lira të përkohshme, situatë e cila cenon funksionimin normal të saj.
  - b. “Pozicion i lirë i përkohshëm” nënkupton rastin kur gjyqtari që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.
  - c. “Pëlqim” është çdo shfaqje vullneti e materializuar e subjektit të kësaj Rregulloreje, ku identifikohet pranimi i tij për transferimin e përkohshëm në një gjykatë të caktuar.
    - ç) “Transferim” është lëvizje e përkohshme e gjyqtarit për një periudhë të caktuar kohe, nga një pozicion i përhershëm në gjykatën e tij, në një pozicion të lirë të përkohshëm në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të lartë nëse plotëson kriteret për atë pozicion.
    - d) “Mungesa e gjyqtarëve të disponueshëm në skemën e delegimit” nënkupton rastin kur në skemën e delegimit nuk ka gjyqtarë të caktuar apo kur gjyqtarët e caktuar janë në pamundësi ligjore për ushtrimin e funksionit. dh) “Gjykatë me ngarkesë më të ulët” nënkupton gjykatën ku gjyqtarët kanë numrin më të ulët të çështjeve gjyqësore që kanë për shqyrtim në momentin e kërkuar kohor.
    - e) “Gjykata e tij apo gjykata nga vjen” nënkupton gjykatën kur gjyqtari është caktuar në mënyrë të përhershme.
    - ë) “Gjyqtari me përvojën më të pakët në atë gjykatë” nënkupton gjyqtarin e gjykatës nga ku do të bëhet transferimi, i cili ka përvojën më të pakët si gjyqtar në të njëjtën shkallë gjykimi”.

## **Neni 4 Parimet dhe kriteret e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit**

1. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm kur nevoja e gjykatës nuk mund të plotësohet nëpërmjet skemës së delegimit.
2. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit kryhet vetëm atëherë kur në gjykatën në të cilën do të transferohet ka të paktën një pozicion të lirë të përkohshëm.
3. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit nuk kryhet nëse efekti negativ që shkakton në gjykatën e tij, çmohet nga Këshilli se, është më i madh se dobia që ai pritët të sjellë në gjykatën ku

- do të transferohet. Për këtë qëllim Këshilli në çdo rast merr mendimin e kryetarit të gjykatës ku gjyqtari është i caktuar në mënyrë të përhershme.
4. Transferimi i përkohshëm, si rregull, bëhet ndërmjet gjyqtarëve nga gjykatat me ngarkesë më të ulët, duke filluar nga gjykatat më të afërta apo ato brenda të njëjtit juridiksion apelit me gjykatën në nevojë. Përgjithësisht, nëse transferimi i përkohshëm sipas këtij rregulli do të cenonte funksionalitetin e gjykatave me ngarkesë më të ulët, transferimi mund të bëhet nga gjyqtarët e gjykatave të tjera, por në çdo rast duke respektuar parimin sipas pikës 3 të këtij neni.
  5. Në rast se ka më shumë se një gjyqtar që jep pëlqimin për transferim të përkohshëm në një gjykatë konkrete, Këshilli vendos të përzgjedhë atë kandidat që vjen nga gjykata me ngarkesën mesatare më të ulët për gjyqtar. Në rast se kandidatët vijnë nga e njëjta gjykatë, Këshilli përzgjedhë kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të gjyqtarëve dhe fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi i tij.
  6. Në caktimin e periudhës së transferimit të përkohshëm, Këshilli mban parasysh mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor në tërësi si dhe gjykatat mes të cilave ndodh transferimi në veçanti. Në çdo rast, periudha e transferimit në kuptim të kësaj Rregulloreje nuk mund të zgjasë më shumë se 1 (një) vit. Pavarësisht kësaj, me pëlqimin e gjyqtarit, transferimi i përkohshëm mund të përsëritet, sipas procedurës së përcaktuar në Kreun II të kësaj Rregulloreje.
  7. Transferimi i përkohshëm kryhet me pëlqimin e gjyqtarit që transferohet. Në rastin kur asnjë gjyqtar nuk jep pëlqimin, transferimi i përkohshëm mund të bëhet edhe pa pëlqim, sipas kritereve të nenit 46/2 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
  8. Në përfundim të periudhës së transferimit të përkohshëm gjyqtari rikthehet në pozicionin e mëparshëm.
  9. Transferimi i përkohshëm nuk bëhet në rastet kur gjyqtari është nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në procedurën e transferimit.

## KREU II

### TRANSFERIMI ME PËLQIM

#### Neni 5

#### Shpallja e vendeve të lira për transferim të përkohshëm

1. Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar të disponueshëm, me kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerëson se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin.
  - “1.1 Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban kriteret e transferimit të përkohshëm sipas rastit në fjalë dhe modelin e dhënies së pëlqimit sipas formularit bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.
  - 1.2 Nëse nevoja e një gjykate, në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një gjyqtar, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm duke ftuar, fillimisht, për të dhënë pëlqimin, gjyqtarin që është i transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme.

Në një rast të tillë, ky gjyqtar mund të transferohet përsëri përkohësisht në gjykatën në nevojë në rast se jep pëlqimin”.

2. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban kriteret e transferimit të përkohshëm sipas rastit në fjalë dhe modelin e dhënies së pëlqimit sipas formularit bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.
3. Nëse nevoja e një gjykate, në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një gjyqtar, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm duke ftuar, fillimisht, për të dhënë pëlqimin, gjyqtarin që është i transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme. Në një rast të tillë, ky gjyqtar mund të transferohet përsëri përkohësisht në gjykatën në nevojë në rast se jep pëlqimin.
4. Këshilli shtyn shpalljen e vendeve të lira për transferim kur çmon se nevoja në gjykatën në të cilën synohet transferimi nuk është emergjente. Këshilli konsideron edhe marrjen e masave të tjera për adresimin e nevojës në gjykatën në të cilën synohet transferimi.
5. Këshilli autorizon Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të ndjekë hapat e mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

## **Neni 6**

### **Kërkimi i pëlqimit nga gjyqtari**

1. Në rastin e shpalljes së një pozicioni të lirë të përkohshëm në një gjykatë, në të cilën ka gjyqtarë të transferuar përkohësisht me pëlqim, dhënia e pëlqimit i kërkohet fillimisht këtij gjyqtari.
2. Nëse gjyqtari i transferuar përkohësisht me pëlqim në një gjykatë që është sërish në nevojë, nuk jep pëlqim, si dhe në çdo rast tjetër të shpalljes së një pozicioni të lirë në një gjykatë në nevojë, dhënia e pëlqimit iu kërkohet të gjithë gjyqtarëve që përmbushin kriteret për pozicionin e lirë të përkohshëm të shpallur.
3. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban edhe kriteret e transferimit të përkohshëm.

## **Neni 7**

### **Verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve**

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikon paraprakisht plotësimin e kriterëve të gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm.
2. Në rastet kur Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konstaton se gjyqtari nuk plotëson kriteret e transferimit, i propozon Këshillit refuzimin e kërkesës së tij për transferim.

## **Neni 8**

### **Shqyrtimi i dhënies së pëlqimit për transferim të përkohshëm**

1. Në vlerësimin e rasteve për transferim të përkohshëm, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës krahas verifikimit të plotësisht të kriterëve të transferimit nga ana e gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin, vlerëson edhe mendimin e kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionet gjyqtari në fjalë.
2. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kryetari i gjykatës dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Mendimi i kryetarit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e gjykatës në tërësi dhe të gjyqtarit në veçanti, numrin total të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në atë gjykatë, seksionin nga i cili vjen gjyqtari apo fushën e të drejtës në të cilën ai shërben, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e gjykatës transferimi i gjyqtarit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari mund të transferohet përkohësisht duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi.
3. Në përfundim të shqyrtimit të rasteve të cilët kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm, bazuar në ndikimin e transferimit, në ngarkesën e gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin, si dhe në përvojën profesionale të tij në raport me fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi, Komisioni përgatit një raport për çdo rast dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim dhe vendim duke i propozuar:
  - a. miratimin e transferimit të përkohshëm;
  - b. refuzimin e transferimit të përkohshëm.

## **Neni 9**

### **Vendimmarrja e Këshillit**

1. Këshilli merr vendim për të transferuar ose jo përkohësisht gjyqtarin që ka dhënë pëlqimin pas shqyrtimit dhe propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë gjyqtarit dhe kryetarëve të gjykatave.
2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit. KREU III

## **TRANSFERIMI PA PELQIM**

## **Neni 10**

### **Fillimi i procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim**

**1.** Kur nevojat e një gjykate për gjyqtarë nuk mund të plotësohen nga skema e delegimit dhe as nga transferimi i përkohshëm me pëlqim i ndonjë gjyqtari, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës njofton Këshillin i cili vendos për nisjen e procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim të një gjyqtari.

## **Neni 11 Kushtet dhe kriteret e veçanta të transferimit pa pëlqim të gjyqtarit**

1. Transferimi pa pëlqim bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:
  - a. kur asnjë gjyqtar nuk jep pëlqimin për t'u transferuar përkohësisht në një gjykatë;
  - b. gjyqtari ose gjyqtarët duhet të jenë nga gjykatat me ngarkesën mesatare më të ulët për gjyqtar, të asaj shkalle për të cilën kërkohet transferimi;
  - c. gjyqtari duhet të jetë me përvojën më të pakët si gjyqtar,
  - d. gjyqtari duhet të përmbushë kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht,
  - e. gjyqtari duhet të vijë nga gjykata e vendosur në të njëjtin juridiksion territorial të Gjykatës së Apelit, mundësisht të ndodhur sa më pranë gjykatës nga e cila vjen gjyqtari. Nëse gjykata

më e afërt ndodhet në një juridiksion territorial të një gjykate tjetër apelit, gjyqtari duhet të dërgohet nga kjo gjykatë. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga gjykata të tjera më të afërta.

2. Transferimi pa pëlqim për një periudhë të caktuar në gjykatat e apelit do të bëhet së pari nga gjyqtarët e apelit, sipas kriterëve të këtij neni. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga gjyqtarë të shkallës së parë që përmbushin kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.
3. Transferimi pa pëlqim për një periudhë të caktuar në gjykatën administrative, do të bëhet së pari nga gjyqtarët e gjykatave administrative, sipas kriterëve të këtij neni. Në rast pamundësie, transferimi do të bëhet nga gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm që përmbushin kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.

## **Neni 12**

### **Identifikimi i gjyqtarit që do të transferohet pa pëlqim**

1. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës kërkon nga kryetarët e gjykatave informacionin e nevojshëm për të përcaktuar gjykatën me ngarkesën më të ulët.
2. Pas përcaktimit të gjykatës me ngarkesën më të ulët, duke mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e pikës 4, të nenit 4, të kësaj Rregulloreje, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon në atë gjykatë gjyqtarin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht. Në rastin e disa gjykatave me ngarkesë më të ulët sipas kësaj pike, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon për secilën nga këto gjykata gjyqtarin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht.
3. Në çdo rast Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson edhe mendimin e kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionet gjyqtari në fjalë.
4. Kryetari i gjykatës dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Me kërkesë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, kryetari i gjykatës dërgon me shkrim brenda dy ditësh mendimin e tij mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarit. Mendimi i kryetarit shpreh vlerësimin e tij mbi ngarkesën e gjykatës në tërësi dhe të gjyqtarit në veçanti, numrin total të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet në atë gjykatë, seksionin nga i cili vjen gjyqtari apo fushën e të drejtës në të cilën ai shërben, pasojat që mund të ketë në ngarkesën e gjykatës transferimi i gjyqtarit, si dhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari mund të transferohet përkohësisht duke mbajtur në konsideratë efektet më të ulëta negative që mund të vijnë nga transferimi. Mendimi i kryetarit të gjykatës nuk është përcaktues.
5. Në përfundim Komisioni përgatit një raport për transferimin pa pëlqim dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim duke i propozuar miratimin e transferimit të përkohshëm dhe periudhën e transferimit.

## **Neni 13 Vendimmarrja e Këshillit**

1. Këshilli merr vendim për të transferuar ose jo përkohësisht pa pëlqim gjyqtarin pas shqyrtimit të propozimit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Vendimi i komunikohet menjëherë gjyqtarit dhe kryetarëve të gjykatave mes të cilave ndodh transferimi.
2. Këshilli mund të vendosë që efektet e vendimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit të fillojnë në një kohë më të mëvonshme nga data e vendimit.

3. Në rast se Këshilli vendos të mos miratojë propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ky i fundit përsërit procedurën e parashikuar nga neni 12 i kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 14**

#### **Përfitimet për shkak të transferimit të përkohshëm**

1. Gjyqtari i cili transferohet përkohësisht sipas kësaj Rregulloreje përfiton kompensim sipas parashikimeve të neneve 15/2 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **Neni 15 Regjistri i transferimeve**

1. Këshilli krijon një regjistër të posaçëm i cili përmban informacion mbi gjyqtarët e transferuar sipas kësaj Rregulloreje, periudhën e transferimit dhe ngarkesën e tyre.

#### **Neni 16**

#### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.